

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE
PËR VITIN 2006

Kuvendi i Shqipërisë,

- njeh rëndësinë e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në bazë të Kushtetutës dhe Kodit Zgjedhor, si institucioni që merret me përgatitjen, mbikëqyrjen, kontrollin dhe verifikimin e procesit zgjedhor;

- përkrah dhe mbështet rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për kontributin e këtij institucioni në arritjen e standardeve për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike.

Konstaton se:

- raporti vjetor i paraqitur nga KQZ-ja për punën e kryer nga ky institucion gjatë vitit 2006 është në përputhje me kërkesat dhe detyrimet ligjore, si dhe i pandikuar nga politika;

- KQZ-ja ka kryer detyrën e saj ligjore në mënyrë që procesi zgjedhor i pjesshëm për organet e qeverisjes vendore në komunën Fajza gjatë vitit 2006 të administrohen në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor;

- ka përdorur me efikasitet fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit për procesin zgjedhor, duke ulur koston e administrimit të votimit për çdo zgjedhës;

- me gjithë presionin e subjekteve të veçanta zgjedhore, KQZ-ja ka kryer në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2006 një volum pune të konsiderueshëm për miratimin e akteve nënligjore, të dokumentacionit dhe logjistikës përkatëse për fazën përgatitore të zgjedhjeve vendore;

- për shkak të presionit politik të disa subjekteve zgjedhore, KQZ-ja nuk ka mundur të përmbushë të gjitha detyrimet e përcaktuara në Kodin Zgjedhor për përgatitjen e zgjedhjeve vendore të vitit 2007;

- është përpjekur të vendosë marrëdhënie të mira dhe të bashkëpunojë në mënyrë të vijueshme me institucionet shtetërore, partitë politike, institucionet ndërkombëtare dhe median.

Kuvendi kërkon që për vitin 2007 t'u kushtohet vëmendje e veçantë këtyre objektivave:

- zbatimit rigoroz të Kushtetutës dhe të legjislacionit zgjedhor në të gjithë veprimtarinë e këtij institucioni;

- respektimit të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë që mbikëqyrin procesin zgjedhor për arritjen e standardeve më të përparuara, si kusht parësor për integrimin euroatlantik të vendit tonë;

- identifikimit të problemeve të menaxhimit të procesit zgjedhor, që vijnë si pasojë e boshllëqeve ose zgjidhjeve ligjore;

- rritjes së performancës, trajnimit dhe aftësimit të vijueshëm profesional të administratës zgjedhore qendrore e vendore;

- krijimit të një klime të përshtatshme bashkëpunimi për zhvillimin e një procesi zgjedhor të lirë, të drejtë e të ligjshëm;

- edukimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve në vijimësi për ushtrimin e së drejtës së tyre kushtetuese, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet demokratike.

28 maj 2007